VENDIM
Nr.975, datë 2.7.2008

PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË NJËSISË SË KONSULENCËS SË KESH SHA-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 7 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e pagave të punonjësve të njësisë së konsulencës së KESH, sh.a. sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Pagat e punonjësve të kësaj njësie të caktohen me ditë pune dhe me produkt të dorëzuar.
3. Ngarkohen organet drejtuese të KESH, sh.a. të miratojnë rregullat e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë së konsulencës.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E PAGAVE NETO (PA TAKSA TË NJËSISË SË KONSULENCËS NË KESH SHA
(në lek/ditë)

Klasifikimi	Niveli	Shkalla			
Kuadër ekspert		1	2	3	4
	Drejtues	55,000	65,000	75,000	85,000
	Punonjës	35,000	45,000	55,000	65,000

Konsulentit i mbulohen gjithashtu dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit brenda dhe jashtë shtetit.